



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 15 qershor 2023
Nr. ref.:RK 2209/23

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI45/23

Parashtrues

Kujtim Amurllahi

Vlerësim i kushtetutshmërisë së aktvendimit të Gjykatës së Apelit [Ac. nr. 6822/22] të 27 dhjetorit 2022

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar dhe
Enver Peci, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Kujtim Amurllahi, nga fshati Ujzë, lokacioni „Fshaj“, komuna e Gjakovës, (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës). Parashtruesin e kërkesës e përfaqëson Teki Bokshi, avokat nga Gjakova.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e aktvendimit [Ac. nr. 6822/ 22] të Gjykatës së Apelit të 27 dhjetorit 2022, në lidhje me aktvendimin [C. nr. 926/ 19] të Gjykatës Themelore në Gjakovë të 10 gushtit 2022.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të kontestuara, përmes të cilave pretendohet se janë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6.1 (E drejta për një proces të rregullt) dhe nenin 1 të Protokollit Shtesë 1 (Mbrojtja e pronës) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113 (1) dhe (7) [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 15 shkurt 2023, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës dorëzoi kërkesën përmes postës në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 20 shkurt 2023, Gjykata pranoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës.
7. Më 2 mars 2023, Gjykata njoftoi përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe dorëzoi një kopje të kërkesës në Gjykatën e Apelit.
8. Më 7 mars 2023, Kryetarja e Gjykatës me vendimin [nr. GJR. KI45/23] caktoi gjyqtarin Enver Peci Gjyqtar raportues dhe me vendimin [nr. KSH. KI45/23], caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Remzije Istrefi-Peci, anëtarë.
9. Më 7 prill 2023, Gjykata i dërgoi përfaqësuesit të parashtruesit të kërkesës një shkresë shtesë përmes të cilës i kërkoi ta plotësoj formularin standard të kërkesës së gjykatës.
10. Më 19 prill 2023, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës dorëzoi formularin e plotësuar të kërkesës së gjykatës.
11. Më 22 maj 2023, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Në bazë të shkresave të lëndës, Gjykata konstaton se thelbi i procedurës në gjykatën e rregullt është çështja e vërtetimit të së drejtës pronësore në lidhje me pronën e paluajtshme, dhe se në lidhje me “*ngastrat kadastrale p- I 70713080-00007-0, ZK*

Ujzë, pronë private, vendi i quajtur Gradish, në sipërfaqe prej 1630 m², shfrytëzimi aktual: bujqësore, kullosë e klasit IV, ndërtimi: shtëpi ndërtesë-tokë ndërtimore dhe oborr, si dhe P-70713080-00008-0, ZK Ujzë, parcelë, pronë private, vendi i quajtur Gradish, në sipërfaqe prej 1371 m², tokë bujqësore e klasit IV.” (në tekstin e mëtejshëm, objekti i kontestit).

13. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës parashtrorë kërkesës në Gjykatën Themelore, kundër personave V. M. J., T. Z.G.O., M.M.G., P.P dhe F.P., përmes së cilës kërkoi vërtetimin e pronësisë mbi objektin e kontestit.
14. Përmes së njëjtës kërkesëpadi, parashtruesi i kërkesës ka paraqitur edhe propozim për caktimin e masës së sigurisë, duke kërkuar vendosjen e masës së sigurisë ndaj kundërshtarëve të lartpërmendur, duke u pamundësuar atyre që të *“tjetërsojnë, të ndryshojnë, të vendosin në hipotekë apo të ndërmarrin çfarëdo veprimi lidhur me paluajtshmëritë në të cilat është drejtuar kërkesëpadia”*.
15. Prandaj, në bazë të sa më sipër, rezulton se parashtruesi i kërkesës ka iniciuar dy procedura gjyqësore pranë gjykatave të rregullta, përkatësisht, **i**) Procedurën gjyqësore në lidhje me vërtetimin e së drejtës së pronësisë mbi objektin e kontestit dhe, **ii**) Propozimin për caktimin e masës së sigurimit mbi objektin e kontestit.
16. Megjithatë, pavarësisht këtij fakti, Gjykata konstaton në kërkesë se parashtruesi i kërkesës konteston ekskluzivisht procedurën gjyqësore në lidhje me **ii**) propozimin për caktimin e masës së sigurimit për objektin e kontestit, dhe rrjedhimisht, Gjykata do të paraqesë vetëm faktet e rastit në vazhdim të aktvendimit, që janë në lidhje të drejtpërdrejt me të dhe do të trajtojë pretendimet për shkelje të mundshme të të drejtave të garantuara me Kushtetutë në lidhje me procedurën gjyqësore të sipërpërmendur.

Procedura gjyqësore në lidhje me propozimin për caktimin e masës së sigurimit

17. Gjykata Themelore, duke vendosur për propozimin e parashtruesit të kërkesës për caktimin e masës së sigurimit, ka mbajtur seancën shqyrtuese ku palët kanë paraqitur argumentet e tyre, përkatësisht kundër-argumentet, me atë rast parashtruesi i kërkesës ka deklaruar;

“ditën e daljes në vend, është konfirmuar mënyra se si familja e paditësit Kujtim Amurllahi, i ka blerë pronësitë lëndore, ku kanë pasur të ndërtuara dhe shtëpitë dhe te banet (ahri i kafshëve) dhe se të njëjtit kanë jetuar deri në konfliktin e fundit të armatosur të vitit 1999, të pa shqetësuar në shtëpinë e tyre dhe pastaj është djegë shtëpia dhe u rrënuar, mirëpo tokët në vazhdimësi sipas marrëveshjes, i ka shfrytëzuar propozuesi, duke e trajtuar veten si pronar. Ka shtuar se edhe sot janë në posedim të pronave kontestuese, mirëpo me rastin e tentimit për të rindërtuar shtëpitë e rrënuara, për tu pajisur me leje ndërtimi, atëherë ka kuptuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë në Gjakovë, se paluajtshmëritë lëndore nuk evidentohen në emër të babait të tij apo anëtarëve të familjes së tij.”

18. Kundërshtarët e masës së sigurimit, përmes përfaqësuesit të tyre, kundërshtuan propozimin për vendosjen e masës mbi objektin e kontestit, duke pretenduar se *“nisur nga gjendja faktike, kundërshtarët e sigurimit janë pronar dhe mbajnë titullin e pronësisë sipas punës e vlefshme Kontratës për 1 shitblerje me numër LRP. nr. 16202/2020, REF. nr. 2020. Po ashtu, kanë theksuar se për të kërkuar masën e sigurisë, duhet të ekzistojë drejta subjektive [...]”*.

19. Më 10 gusht 2020, Gjykata Themelore nxori aktvendimin [C. nr. 926/ 19], përmes të cilit refuzoi në tërësi propozimin për caktimin e masës së sigurimit të parashtruesit të kërkesës.
20. Në aktvendimin [C. nr. 926/ 19], Gjykata Themelore paraqiti një arsyetim të cilin Gjykata do ta përmbledhë më poshtë si në vijim;

„Gjykata, pasi ka shqyrtuar propozimin për caktimin e masës së sigurimit, deklarimet e palëve në procedurë, si dhe pasi ka vlerësuar provat [...], deklaratat e dëshmitarëve [...], certifikatën për paluajtshmërinë [...], historiatin për ngastrat kadastrale [...], daljes në vend [...], ekspertizën gjeodezike të datës 04.07.2022, e përpiluar nga eksperti i licencuar i gjykatës Xhelil Tertini, e datës 06.06.2022, vlerësoj se propozuesi i masës së sigurimit në këtë rast, nuk ka arritur që të bëjë të besueshme ekzistimin e të drejtës apo kërkesës së tij subjektive siç kërkohet edhe me dispozitën e nenit 297 paragrafi 1 pika a) të LPK-së, në të cilën parashihet se “Masa e sigurimit mund të caktohet: a) në qoftë se propozuesi i sigurimit e bën të/besueshëm ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij ” “

“Gjykata ka provuar të kundërtën e asaj që propozuesi i sigurimit ka paraqitur me propozimin për caktimin e masës së sigurisë [...] Përfundimisht, në shqyrtimin për caktimin eventual të masës së sigurimit, është provuar se vet propozuesi ka ndërmend që të ndërtoj shtëpi në atë paluajtshëm, me ndërtimin e shtëpisë në vendin ku pretendon se ka ekzistuar shtëpia e prindërve të tij, veprim ky që do të konsistonte me ndryshimin e gjendjes faktike në teren.

Andaj, në këtë rast gjykata vlerëson se për aprovimin eventuali të masës së sigurimit, duhet të plotësohen të dyja kushtet e kërkuara nga neni 297 paragrafi 1 të LPK-së, e meqenëse propozuesi i sigurimit ka dështuar të provoj plotësimin e këtyre kushteve [...]”

21. Kundër aktvendimit [C. nr. 926/19], të Gjykatës Themelore, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, zbatimit të së drejtës materiale.
22. Më 27 dhjetor 2022, Gjykata e Apelit nxori aktvendimin [Ac. nr. 6822/22], përmes të cilit e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar.
23. Në arsyetimin e aktvendimit, Gjykata e Apelit ndër të tjera theksoi:

“Kolegji i Gjykatës së Apelit, me një kujdes të shtuar i ka analizuar pretendimet ankimore në raport me provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe erdh në përfundim se këto pretendime tani për tani nuk qëndrojnë sepse masa siguroese është mjet për parandalimin e ndryshimit të gjendjes ekzistuese të kërkesëpadsisë dhe kjo masë mund të caktohet po qe se propozuesi i masës e bënë të besueshme të drejtën e tij subjektive dhe paraqet prova apo rrethana që e bindin gjykatën se pa caktimin e masës së sigurisë ekziston rreziku serioz se kundërshtari i sigurimit me veprimin apo mos veprimin e tij mund t’ia pamundëson apo vështirëson dukshëm realizimin e kërkesëpadsisë. Në rastin konkret propozuesi i masës së sigurimit nuk ka ofruar ndonjë provë konkrete se kundërshtarët e sigurimit, vërtet mund të pamundësojnë apo vështirësojnë dukshëm realizimin e kërkesëpadsisë në ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do mund të ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit, respektivisht vendimi lidhur

me masën e sigurisë nuk përfaqëson çështje të gjykuar e as nuk e prejudikon vendosjen e çështjes lidhur me meritat e saj.”

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

24. Parashtruesi i kërkesës thekson se për shkak të moscaktimit të masës së sigurisë nga gjykatat e rregullta, ka ardhur deri te shkelja e të drejtave dhe lirive të tij të garantuara në nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 (E drejta për një proces të rregullt) dhe nenin 1 të Protokollit Shtesë 1 (Mbrojtja e pronës) të KEDNJ-së.
25. Megjithatë, pavarësisht se parashtruesi në kërkesë pretendoi shkelje të neneve 31 dhe 46 të Kushtetutës, në kërkesë ai dha një arsytim vetëm në lidhje me shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
26. Në mbështetje të kësaj, parashtruesi i kërkesës arsyeton shkeljet e përmendura të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së me pretendimet e mëposhtme:

- i) Gjykata e shkallës së parë nxori konkluzion të gabuar në bazë të provave të paraqitura, sepse provat e paraqitura nga paditësi vërtetohin besueshmërinë e kërkesës për caktimin e masës së sigurimit, por Gjykata e shkallës së parë erdhi në përfundim të gabuar duke miratuar gabimisht të drejtën materiale në dëm të paditësit - propozuesit.

Parashtruesi i kërkesës pretendon “në kuptim të nenit 297. a. dhe b. të LPK, propozuesi i sigurimit e ka bërë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij, dhe se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtarë do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë lëndore, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjerave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit”.

- ii) Parashtruesi i kërkesës, duke iu referuar edhe praktikës së GJEDNJ-së dhe të Gjykatës, thekson se e drejta për një gjykim të drejtë përfshin të drejtën për një vendim të arsyetuar dhe se gjykatat duhet të “shpjegojnë me qartësi të mjaftueshme arsyet mbi të cilat kanë mbështetur vendimet e tyre.” Lidhur me këtë, ai konsideron se gjykatat nuk kanë arsyetuar siç duhet vendimet e tyre në lidhje me propozimin e tij për vendosjen e masës së sigurisë.
27. Sipas sa më sipër, parashtruesi i kërkesës ka dy pretendime para gjykatës që ai ngre në lidhje me shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, dhe ato janë; **a)** pretendimet për vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimin e gabuar të së drejtës materiale; **b)** pretendimet në lidhje me vendimet e paarsyetuara të gjykatave që nuk plotësojnë standardet e vendosura nga GJEDNJ-së dhe Gjykata Kushtetuese në aktgjykimet e tyre.
28. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që ta deklarojë kërkesën të pranueshme, për të përcaktuar se aktvendimi i kontestuar i Gjykatës së Apelit dhe i Gjykatës Themelore nuk janë në përputhje me nenet 31 dhe 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 dhe nenin 1 të protokollit shtesë 1 të KEDNJ-së.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. “Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj”.

Neni 46 [Mbrojtja e Pronës]

1. E drejta e pronës është e garantuar.
2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.
3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave ekspropriohet.
[...]

KONVENTA EVROPIANE PËR TE DREJTAT E NJERIUT

Neni 6.1 (E drejta për një proces të rregullt)

1. “Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile.
[...]

Neni 1 (Mbrojtja e pronës)

“Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare. Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk çënojnë të drejtën e Shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera.”

Ligji nr. 03/L- 006 PËR PROCEDURËN KONTESTIMORE

KREU XXI SIGURIMI I KËRKESËPADISË

“Neni 297.

297.1 Masa e sigurimit mund të caktohet:

a) në qoftë se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij, dhe

b) në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtarë do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit”.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

29. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parapara me Ligj dhe të specifikuara më tej dhe Rregullore të punës.

30. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

[...]

31. Gjykata gjithashtu i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47 (Kërkesa individuale)

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48 (Saktësimi i kërkesës)

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht secilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49 (Afatet)

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

32. Për sa i përket plotësimit të këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston aktin e autoritetit publik, përkatësisht kushtetutshmërinë e aktvendimit [Ac. nr. 6822/ 22] të Gjykatës së Apelit të 27 dhjetorit 2022, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka theksuar të drejtat dhe liritë për të cilat pretendon se i janë shkelur në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit; dhe e ka parashtruar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
33. Gjykata gjithashtu i referohet rregullit 39 (2) të Rregullores së punës, i cili përcakton:
- (2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.*
34. Gjykata së pari thekson se rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ) dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.
35. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave, si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”, dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta” (shih rastet e GJEDNJ-së, [Kemmachev kundër Francës](#) kërkesa nr. [17621/01](#), kategoria (i), [Mentzen kundër Lituaniës](#), kërkesa nr. [71074/01](#), kategoria (ii) dhe [Trofimchuk kundër Ukrainës](#) kërkesa nr. [4241/03](#), kategoria (iii)).
36. Me qëllim të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht vlerësimit nëse e njëjta është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtojë esencën e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
37. Duke iu rikthyer rastit konkret, Gjykata rikujton se thelbi i kërkesës konkrete ka të bëjë me procedurën që gjykatat e rregullta që kanë zhvilluar lidhur me propozimin për vendosjen e masës së sigurisë për objektin e kontestit, deri në përfundimin e procedurës gjyqësore. lidhur me kërkesëpadinë që parashtruesi i kërkesës ka iniciuar në lidhje me vërtetimin e pronësisë.

38. Duke pasur parasysh këtë, Gjykata vëren se pretendimet e parashtruesit të kërkesës në vazhdim do të shqyrtohen ekskluzivisht në lidhje me procedurën gjyqësore në të cilën gjykatat e rregullta vendosën për propozimin për vendosjen e masës së sigurisë.
39. Prandaj, duke shqyrtuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me procedurën e kontestuar gjyqësore, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës e lidh shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së me a) vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, b) paarsyeshmëria e vendimeve të gjykatave të cilat vendosën lidhur me propozimin e tij..

a) Vërtetimi i gabuar i gjendjes faktike dhe zbatimi i gabuar i së drejtës materiale

40. Lidhur me pretendimin e parë të parashtruesit të kërkesës, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës e lidh vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimin e së drejtës materiale me faktin se gjykatat kanë vërtetuar gabimisht se nuk ishin plotësuar kushtet e parapara me nenin 297.1 të LPK-së, i cili rregullon çështjen e vendosjes së masës së sigurisë.
41. Gjykata rikujton se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë konkluzionet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale dhe se ajo nuk mund të vlerësojë vetë faktet të cilat e kanë bërë një gjykatë të rregullt të marrë një vendim e jo një tjetër. Në të kundërtën, Gjykata do të vepronte si gjykatë e e “shkallës së katërt”, që do të rezultonte në shpërfilljen e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj (shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së: [García Ruiz kundër Spanjës](#), nr. 30544/96, aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe referencat e përdorura aty; dhe shih, gjithashtu rastet e Gjykatës: [KI145/20](#), parashtruese: *Hafize Gashi*, aktvendim për papranueshmëri i 22 prillit 2021, paragrafi 34, [KI49/19](#), parashtrues: *Shoqëria Aksionare Limak Kosovo International Airport S.H.A. “Adem Jashari”*, aktvendim i 31 tetorit 2019, paragrafi 48.
42. Gjykata, megjithatë, thekson se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe ajo e Gjykatës përcaktojnë rrethana nën të cilat duhet të bëhen përjashtime nga ky qëndrim. Siç u theksua më lart, përderisa gjykatat e rregullta kanë detyrë primare të zgjidhin problemet rreth interpretimit të ligjit të aplikueshëm, roli i Gjykatës është që të sigurohet apo të verifikojë që efektet e këtij interpretimi të jenë në përputhje me Kushtetutën dhe KEDNJ-në (shih, rastin e GJEDNJ-së, [Miragall Escolano dhe të tjerët kundër Spanjës](#), Aktgjykim i 25 majit 2000, paragrafët 33-39; shih gjithashtu edhe rastin e Gjykatës [KI154/17 dhe KI05/18](#), parashtrues: *Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “BARBAS”*, aktvendim për papranueshmëri i 12 gushtit 2019, paragrafi 64). Në parim, një përjashtim i tillë, ndërlidhet me raste të cilat rezultojnë të jenë dukshëm arbitrare, duke përfshirë ato në të cilat, një gjykatë ka “aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar” në një rast specifik dhe i cili mund të ketë rezultuar me “konkluzione arbitrare” apo “qartazi të paarsyeshme” për parashtruesin përkatës.
43. Duke iu rikthyer thelbit të pretendimit të parashtruesit të kërkesës se gjykatat nuk e kanë vlerësuar drejt përmbushjen e kushtit të nenit 297.1 të LPK-së, Gjykata rikujton se dispozita ligjore e përmendur në pjesën përkatëse thekson;

“297.1 Masa e sigurimit mund të caktohet:

a) në qoftë se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij, dhe

b) në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtare do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit.”

44. Prandaj, me shqyrtimin e dispozitës ligjore të sipërpërmendur, Gjykata konstaton se ajo parashikon dy kushte në përmbajtjen e saj, përkatësisht **i)** “ekzistencën e së drejtës subjektive” dhe **ii)** “ekzistencën e rrezikut”, të cilat duhet të plotësohen në mënyrë kumulative, në mënyrë që të mund të miratohet propozimi për vendosjen e masës së sigurisë.
45. Për rrjedhojë, kushti i parë është përcaktimi i ekzistencës së “të drejtës subjektive” të propozuesit për caktimin e masës së sigurimit mbi objektin që është objekt i atij propozimi. Kjo nënkupton që propozuesi i masës së sigurimit, në procesin e paraqitjes së propozimit në gjykatë, duhet të dëshmojë ekzistencën e së drejtës së tij subjektive mbi objektin me një vendim të mëparshëm të gjykatës ose të një organi administrativ, testament, kontratë, dokument tjetër ekzekutive, ose ndonjë titull tjetër ligjor.
46. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se është obligim i Gjykatës Themelore që, si pikënisje në procesin e vendimmarrjes në bazë të propozimit të propozuesit, para së gjithash të konstatojë nëse propozuesi ka “të drejtë subjektive”, që nënkupton marrjen e disa veprimeve procedurale nga ana e saj në bazë të të cilave ajo duhet ta vërtetojë atë fakt.
47. Ajo që Gjykata konstaton në aktvendimin e kontestuar në lidhje me vërtetimin e ekzistencës së “të drejtës subjektive” të parashtruesit të kërkesës është se Gjykata Themelore në vlerësimin e saj nuk është mbështetur vetëm në provat e paraqitura nga propozuesi, por ka shkuar edhe një hap më tej që nënkuptonte dëgjimin e dëshmitarëve, angazhimin e ekspertëve, rishikim të historikut të parcelave në fjalë, vizita në vendin ku ndodhen parcelat në fjalë, si dhe ekspertizë gjeodezike. E gjithë kjo ka ndikuar që Gjykata Themelore të konstatojë se parashtruesi i kërkesës si propozues i masës së sigurisë “*nuk ka arritur që të bëjë të besueshme ekzistimin e të drejtës apo kërkesës së tij subjektive siç kërkohet edhe me dispozitën e nenit 297 paragrafi 1 pika a) të LPK-së.*”
48. Duke pasur parasysh këtë, Gjykata vlerëson se Gjykata Themelore, në procedurën e vërtetimit të ekzistencës së “të drejtës subjektive” të parashtruesit të kërkesës, zbatoi plotësisht veprimet procedurale, të cilat çuan në vlerësimin dhe përfundimin e saj se ai nuk e plotëson kushtin e parë të nenit 297.1 të LPK-së.
49. Gjykata thekson këtu se ajo nuk do të lëshohet në vlerësimin e cilësisë së konkluzioneve të Gjykatës Themelore në lidhje me vlerësimin e përmbushjes së këtij kushti sepse, siç ka theksuar tashmë Gjykata, “*nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë konkluzionet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike.*”
50. Gjykata gjithashtu konstaton se Gjykata Themelore është marrë me vlerësimin e “ekzistencës së rrezikut”, si kusht i dytë i kërkuar i nenit 297.1 të LPK-së, ku ka konkluduar “*se propozuesi nuk ka mundur që të vërtetojë ekzistimin e rrezikut siç përcaktohet me piken b) të nenit 297 paragrafi 1 të LPK-së, nga personat ndaj të cilëve ka kërkuar vendosjen e masës.*”
51. Për më tepër, Gjykata nuk mund të mos vërej se vetë procedura e vlerësimit të ekzistimit të “rrezikut” e shtyu Gjykatën Themelore të konkludonte të kundërtën e asaj

që parashtruesi paraqiti në kërkesë. Gjykata Themelore e arsyetoi atë konkluzion si në vijim, “është provuar se vet propozuesi ka ndërmend që të ndërtoj shtëpi në atë paluajtshmëri, me ndërtimin e shtëpisë në vendin ku pretendon se ka ekzistuar shtëpia e prindërve të tij, veprim ky që do të konsistonte me ndryshimin e gjendjes faktike në teren”.

52. Prandaj, Gjykata është e mendimit se Gjykata Themelore i ka përmbushur plotësisht obligimet e parapara me nenin 297.1 të LPK-së në drejtim të vlerësimit të përmbushjes së kushteve të propozimit për vendosjen e masës së sigurimit të paraqitur nga parashtruesi i kërkesës.
53. Më tej, për sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës se Gjykata Themelore në procedurën e vendimmarrjes lidhur me propozimin për vendosjen e masës së sigurimit ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale, Gjykata e konsideron këtë pretendim të parashtruesit të pabazuar, për arsyet e mëposhtme; vetë neni 297.1 i LPK-së, për të cilin parashtruesi i kërkesës vlerëson se është zbatuar gabimisht, paraqet bazën që rregullon çështjen e vendosjes së masës së sigurimit, rrjedhimisht, në mënyrë që Gjykata të mund të zbatojë të drejtat që rrjedhin nga vetë neni, si kusht i parë i zbatimit të tij, duhet të shqyrtojë përmbushjen e kushteve të përcaktuara pa të cilat nuk është i mundur zbatimi i të drejtave të tij përmbajtjesore. Pra, pa plotësimin e kushteve të parashikuara që mundësojnë zbatimin e së drejtës, nuk ka zbatim të nenit 297.1 të LPK-së, dhe si rrjedhojë nuk ka zbatim të gabuar të së drejtës materiale të cilit parashtruesi i referohet në kërkesë.
54. Duke pasur parasysh këtë, Gjykata konstaton se pretendimi i parë i parashtruesit të kërkesës për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së në kontekstin e vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të së drejtës materiale është qartazi i pabazuar.

b) vendimet e paarsyetuara të gjykatave që vendosën për propozimin për vendosjen e masës së sigurimit

55. Në lidhje me pretendimin e parashtruesit të kërkesës se vendimet e gjykatave që kanë vendosur për propozimin për caktimin e masës së sigurisë nuk janë në përputhje me praktikën e GJEDNJ dhe të Gjykatës, Gjykata thekson se neni 6 paragrafi 1 i detyron gjykatat të japin arsye për vendimet e tyre, por kjo nuk do të thotë se kërkohet përgjigje e detajuar lidhur me secilin argument (shih rastin e GJEDNJ-së, [Van de Hurk kundër Holandës](#), nr. [16034/90](#), Aktgjykim i 19 prillit 1994, paragrafi 61; [García Ruiz kundër Spanjës](#), nr. [30544/96](#), Aktgjykim i 29 janarit 1990, paragrafi 26; [Perez kundër Francës](#), nr. [47287/99](#), Aktgjykim i 12 shkurtit 2004, paragrafi 81).
56. Nga natyra e vendimit që merr gjykata varet nëse Gjykata është e detyruar ta arsyetojë atë, dhe kjo mund të vendoset vetëm në dritën e rrethanave të rastit në fjalë: është e nevojshme të merren parasysh, ndër të tjera, llojet e ndryshme të parashtrësive që një palë mund t'i paraqesë gjykatës, si dhe dallimet që ekzistojnë midis sistemeve juridike të vendeve në lidhje me dispozitat ligjore, rregullat zakonore, pozicionet juridike dhe paraqitjen dhe hartimin e aktgjykimeve (shih rastet e GJEDNJ-së, [Ruiz Torija kundër Spanjës](#), nr. [18390/91](#), Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 29; [Hiro Balani kundër Spanjës](#), nr. [18064/91](#), Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 27).
57. Prandaj, duke shqyrtuar thelbin e pretendimit për shkeljen e të drejtës për një vendim gjyqësor të paarsyetuar, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës e lidh shkeljen në fjalë, si me aktvendimin e Gjykatës Themelore ashtu edhe me vendimin e Gjykatës së Apelit, lidhur me mungesën e arsyetimit me rastin e vlerësimit të plotësimin të kushteve për vendosjen e masës së sigurisë sipas propozimit të tij.

58. Megjithatë, pas shqyrtimit të përmbajtjes së dy aktvendimeve, Gjykata vlerëson se ato plotësojnë plotësisht standardet e përcaktuara të vendimeve të arsyetuara gjyqësore në lidhje me natyrën e procedurës që kishin trajtuar dhe kishin vendosur.
59. Në mbështetje të kësaj, Gjykata rikujton se në pjesën e mëparshme të aktvendimit, ajo ishte marrë me shqyrtimin e detajuar të përmbajtjes së vendimit të Gjykatës Themelore në procesin e vlerësimit të përmbushjes së kushteve të parapara të nenit 297.1 të LPK-së, ku nuk ka konstatuar mangësi apo lëshime që do të çonin në vlerësimin se konkluzioni i Gjykatës Themelore ishte i padrejtë.
60. Për më tepër, Gjykata nuk e konsideron të pajustificuar arsyetimin e Gjykatës së Apelit, për arsye se Gjykata e Apelit analizoi përsëri pretendimet ankimore me kujdes të veçantë në lidhje me provat që gjenden në shkresat e lëndës përkitazi me konkluzionet e Gjykatës Themelore lidhur me vlerësimin e përmbushjes së kushteve të nenit 297.1 të LPK-së, ku ka konstatuar se ato nuk qëndrojnë si të tilla dhe për të cilat ka dhënë arsyetimin si në vijim:

“masa siguroese është mjet për parandalimin e ndryshimit të gjendjes ekzistuese të kërkesëpadisë dhe kjo masë mund të caktohet po qe se propozuesi i masës e bënë të besueshme të drejtën e tij subjektive dhe paraqet prova apo rrethana që e bindin gjykatën se pa caktimin e masës së sigurisë ekziston rreziku serioz se kundërshtari i sigurimit me veprimin apo mos veprimin e tij mund t’ia pamundëson apo vështirëson dukshëm realizimin e kërkesëpadisë.

Në rastin konkret propozuesi i masës së sigurimit nuk ka ofruar ndonjë provë konkrete se kundërshtarët e sigurimit, vërtet mund të pamundësojnë apo vështirësojnë dukshëm realizimin e kërkesëpadisë në ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do mund të ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit”.

61. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron të pabazuara pretendimet e parashtruesit të kërkesës se aktvendimi i Gjykatës Themelore dhe ai i Gjykatës së Apelit nuk i plotësojnë standardet e arsyetimit të vendimit të gjykatës.
62. Si përfundim, Gjykata vlerëson se të drejtat e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së nuk janë shkelur në procedurën e vendosjes së masës së sigurisë, për të gjitha arsyet e sipërpërmendura.
63. Gjykata gjithashtu vërejtë në kërkesë se parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendonte shkelje të nenit 46 të Kushtetutës, megjithatë, në kërkesë Gjykata nuk gjeti argumentet e tij që do të mbështesnin këto pretendime, dhe rrjedhimisht Gjykata nuk do t’i trajtojë ato në vazhdim të aktvendimit.
64. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar në tërësinë e saj, për arsye se pas analizës u konstatua se pretendimet e parashtruesit të kërkesës kualifikohen si pretendime që bëjnë pjesë në kategorinë (iii) e pretendimeve “*të pambështetura apo të paarsyetuara*”, prandaj këto pretendime të parashtruesit janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.
65. Prandaj, kërkesa duhet të refuzohet si e papranueshme në baza kushtetuese, siç përcaktohet me nenin 113 (7) të Kushtetutës, parashikohet me nenet 47 dhe 48 të Ligjit dhe specifikohet më tej në rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113. 7 të Kushtetutës, nenet 47 dhe 48 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, më 22 maj 2023, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Enver Peci



Gresa Caka Nimani